



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2022:235648

Datë: 18.11.2022

Numri i dokumentit: 03665449

P.nr.409/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me bashkëpunëtoren profesionale Diellza Zeqiri Latifi, në çështjen penale kundër të pandehurit F. K. nga V. rruga “A. Rr.”, nr..., për shkak të veprës penale Dhuna në Familje nga neni 248 par.3 dhe par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2071/22 të datës 10.11.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, i datës 17.11.2022, në praninë e Prokurorit të shtetit Zef Prendrecaj, të pandehurit Faton Krasniqi dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare av.Veton Uka dhe të dëmtuarës Emine Shabani Krasniqi, pas shpalljes së aktgjykimit me datë 17.11.2022, me datën 18.11.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: F. K. nga V. me nofken Q, nga babai R dhe nëna A e gjinisë S. i lindur me datë ..., në V. ku edhe jeton në rrugën “A.Rr.”, nr. ..., ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, prind i dy fëmijëve, me numër personal shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në paraburgim nga dt.14.10.2022, i gjykuar edhe më parë me Aktgjykimet P.nr.136/2013, P.nr.24/2015, P.nr.130/2015, P.nr. 168/2015, P.nr. 42/2014, P.nr.293/2017, P.nr.316/2016, P.nr.01/2018, P.nr.276/20, P.nr.109/20, P.nr. 195/2021, P.nr.152/19, P.nr 401/2021, P.nr.10/21, P.nr. 1224/2019, P.nr. 262/2021 si dhe P.nr.110/2020.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Më dt.14.10.2022, rreth orës 20:00 në rrugën “A. Rr.” në V. i pandehuri ka ushtruar dhunë fizike e psikike, keqtrajtim, me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda familjes, në atë mënyrë që kur është kthyer në shtëpi nën ndikimin e alkoolit ka hyrë në kuzhinë ku bashkëshortja e tij E. Sh. ka qenë duke përgatitur ushqim, i ka bërtitur asaj dhe e ka sulmuar duke e shtyrë, e me këtë ka dëgjuar djali i tij G.K. i cili po mësonte në dhomën pranë, ka dal nga dhoma, ka hyrë në kuzhinë në mënyrë që të pandehurin ta largoj nga e dëmtuara, dhe atëherë i pandehuri F. K. ka shkuar në oborr ku e ka marrë një sëpatë dhe të njëjtën e ka sjellë në drejtim të të dëmtuarve E.Sh. dhe G. K. duke iu shkaktuar shqetësim, ankth dhe frikë,

- Me këtë ka kryer veprën penale Dhuna në familje nga neni 248 par.3 dhe par.1 të

KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 79 dhe nenit 248 par.3 dhe par.1 të KPRK-së dhe neneve 248, 365, 367, 450, 461 dhe 463 të KPPK-së, e

G J Y K O N

TË PANDEHURIT: F. K. i shqipton DËNIM MË BURG në kohëzgjatje prej një (1) viti, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt.14.10.2022, ashtu që kjo masë do t'i vazhdohet deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi, por jo më tepër se një (1) vit nga dita kur i është caktuar masa e paraburgimit, dhe

DËNIM ME GJOBË në shumën prej gjashtëqind euro (600€), i cili dënim do të ekzekutohen 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se i pandehuri refuzon të paguaj këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar për çdo njëzet euro (20 €) të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

E DËMTUARA E. Sh. K. ka hequr dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike lidhur me këtë çështje penale.

I DËMTUARI G. K. udhëzohet në kontest të rregullt civil, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike lidhur me këtë çështje penale.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej tridhjetë euro (30€).

DETYROHET i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë euro (30€).

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.2071/22 të datës 10.11.2022, kundër të pandehurit F. K. nga V. rruga “A. Rr.”, nr....., për shkak të veprës penale Dhuna në Familje nga neni 248 par.3 dhe par.1 të KPRK-së.

Deklarimi i të pandehurit për pranimin e fajësisë

Gjyqtari i vetëm gjykues ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar më datën 17.11.2022, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit i pandehuri ka deklaruar

se e ka kuptuar aktakuzën duke shtuar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi që ka vlerësuar se një pranim i tillë është në përputhje me nenin 248 të KPPK-së, dhe me provat e tjera që mbështesin këtë aktakuzë, dhe meqenëse i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, gjykatës i propozon që ta aprovoi pranimin e fajësisë dhe të pandehurit t'i shqiptoj dënim sipas ligjit.

E dëmtuara E. Sh. K. ka deklaruar se e pranon pranimin e fajësisë nga i pandehuri, dhe njëherit heq dorë nga kërkesa pasurore juridike lidhur me këtë çështje penale.

I dëmtuari G. K. edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, i njëjti nuk ka prezantuar në këtë seancë të shqyrtimit fillestar.

Avokati mbrojtës i të pandehurit F. K., av. Veton Uka ka deklaruar se pas konsultimit me të mbrojturin e tij, i njëjti ka vendosur që vullnetarisht duke i ditur natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë ta bëjë pranimin e fajësisë në këtë fazë të procedurës penale, duke i propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit, pranimin e fajësisë nga i pandehuri ta marrë si rrethanë lehtësuese, e po ashtu si rrethanë lehtësuese ta marrë edhe shprehjen e keqardhjes së të pandehurit, kërkim faljen nga ana e tij, bashkëpunimin e tij me organet proceduese, ashtu që ndaj të pandehurit të shqiptohet një dënim sa më i butë, ndërsa sa i përket masës së paraburgimit i ka propozuar gjykatës që kjo masë të ndërpritet, pasi që kanë pushuar shkaqet ligjore, duke marrë parasysh se raportet e të pandehurit me të dëmtuarit tani më janë rregulluar.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: Raport fillestar i incidentit me nr. të rastit 2022-BD-954 i dt.14.10.2022, Procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin i dt.15.10.2022, procesverbali i marrjes në pyetje për të dëshmitarin i dt.14.10.2022, procesverbal i marrjes në pyetje për të dëmtuarin i dt.14.10.2022, raport i oficerit i dt.14.10.2022, raport ditor i dhunës në familje i dt.14.10.2022, fotoalbumi me 3 fotografi, informacionet e personit nga evidenca penale të siguruar nga Policia e Kosovës për të pandehurin., si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjendja faktike e vërtetuar

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri me dashje ka kryer veprën penale Dhuna në familje nga neni 248 par.3 dhe par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 248 par.1 të KPRK-së është parashikuar se formën themelore të veprës penale Dhuna në familje e kryen “*Kushdo që e kryen dhunën ose keqtrajtimin fizik, psikologjik ose ekonomik me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda një marrëdhënieje familjare...*”, ndërsa që par.3 i këtij neni përcakton se “*Çdo anëtar i familjes që ushtron dhunë ose keqtrajtim fizik, psikologjik, seksual ose ekonomik ndaj anëtarit tjetër të familjes së tij/saj...*” dhe për të cilin është përcaktuar dënim me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet, përkatësisht dënim komulativ.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana rënduese ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, në rastin konkret dëmin e shkaktuar palëve të dëmtuara, faktin se dhuna është kryer brenda familjes e që është edhe element konstituiv i kësaj vepre penale, i njëjti është i njohur për gjykatës si kryes i veprave penale të kësaj natyre me aktgjykimet P.nr.136/2013, P.nr.24/2015, P.nr.130/2015, P.nr. 168/2015, P.nr. 42/2014, P.nr.293/2017, P.nr.316/2016, P.nr.01/2018, P.nr.276/20, P.nr.109/20, P.nr. 195/2021, P.nr.152/19, P.nr 401/2021, P.nr.10/21, P.nr. 1224/2019, P.nr. 262/2021 si dhe P.nr.110/2020, ndërsa si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri në shqyrtim fillestar, pendimin e të pandehurit për kryerjen e kësaj vepre penale, premtimin që i ka bërë gjykatës se nuk do të përsërisë më vepra penale të kësaj apo natyrës tjetër.

Sipas bindjes së gjykatës, në kohëzgjatje prej një (1) viti, në të cilin dënim do t’i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt.16.10.2022 dhe dënimi me gjobë në shumën prej gjashtëqind euro (600€), i cili dënim do të ekzekutohen 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, të pandehurit i është vazhduar edhe masa e paraburgimit konform nenit 367, par.1, nënpar.1.1 të KPPK-së, deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi, por jo më tepër se koha e dënimi të shqiptuar me këtë aktgjykim.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike, kompensimin e viktimave të krimit dhe shpenzimet e procedurës

Vendimin lidhur me kërkesën pasurore – juridike për të dëmtuarën E. Sh. K. gjykata e ka marrë

në bazë të nenit 461 të KPPK-së, pasi që e dëmtuara në seancën e shqyrtimit fillestar ka heqë dorë nga kërkesa pasurore – juridike.

Ndërsa, vendimin lidhur me kompensimin e dëmit ndaj të dëmtuarit G. . gjykata e ka marrë në bazë të nenit 463 par.1 dhe par. 2 të KPPK-së, në të cilin parashihet se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil.”*

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 par.1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 nënpar 2.6 të KPPK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.409/22, datë 18.11.2022

Bashkëpunëtoreshë profesionale
Diellza Zeqiri Latifi

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.